

## Siguria, certifikohen 77 oficerë të rinj që i shtohen shërbimit në shkolla

77 oficerë të rinj iu bashkuan skuadrës së oficerëve të sigurisë, që kanë një rol kyç në garantimin e një ambienti të shëndetshëm për nxënësit e arsimit parauniversitar. Në një ceremoni ku morte pjesë ministria e Arsimit dhe Sportit, znj. Ogerta Manastirliu dhe ministri i Brendshëm, z. Ervin Hoxha, u shpërndanë certifikata për punonjësit e rinj që u trajnuan nga Akademia e Sigurisë, si pjesë e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Sigurinë në Shkolla. Me vendimin e fundit të qeverisë numri i oficerëve të sigurisë në shkolla shkon në 400.



## Historike, Giro d'Italia zhvillon 3 etapa në Shqipëri, ndiqet në mbarë botën



Nga 9 deri më 11 maj 2025 Shqipëria mikprit një nga ngjarjet më të mëdha sportive në botë, Giro d'Italia. Rreth 180 çiklistë kampionë nga 23 ekipe prestigjioze ndërkombëtare përshkuan 3 etapat e para të garës së famshme çiklistike, nga Durrësi në Tiranë e Vlorë, duke u ndjekur nga qindra milionë teleshikues në gjithë globin. Një rast i jashtëzakonshëm që pati një jehonë të paimagjinueshme në mbarë botën, ku u fol për bukuritë natyrore, mikpritjen dhe organizimin nga pala shqiptare. Organizimi i Giro d'Italia-s më parë i është besuar vetëm 14 herë vendeve jashtë Italisë. Dhe tani, Shqipëria shkruan emrin e saj përkrah San Marinos, Greqisë, Hollandës, Izraelit dhe shumë vendeve të tjera që kanë pasur nderin ta presin këtë garë. Tanimë Shqipëria është futur në hartën e vendeve-partnere të aktiviteteve të mëdha.

## NXËNËSIT E KLASAVE TË PESTA ZHVILLUAN TESTIMIN KOMBËTAR

Mbi 27 mijë nxënës të klasave të pesta në të gjithë vendin zhvilluan testimin kombëtar VANAF, për matjen e arritjeve në arsimin fillor në lëndët Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre. Bashkë me rezultatet do të evidentohen edhe problematikat dhe mangësitë të nxënësit që do të kalojnë në arsimin e mesëm të ulët. Në të njëjtën kohë ky testim shërben edhe si matje e punës së mësuesve të arsimit fillor përgjatë 5 viteve, gjatë të cilave që ata kujdesen për edukimin e klasave të tyre. Testimi i VANAF hap stinën e provimeve të shtetit, që do të pasohet nga PKAB dhe Matura Shtetërore 2025.



## DY PROGRAME TË REJA NË MBËSHTETJE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

"Bridge" dhe Programi i Bursave janë dy programet e reja të prezantuara nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Këto dy programe do të shërbejnë si ura bashkëpunimi mes diasporës akademike dhe universiteteve shqiptare për rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, si dhe mbështetjen e të rinjve shqiptarë për të ndjekur studimet brenda e jashtë vendit. Programi "Bridge" do të sjellë ekspertizën e diasporës akademike në hartimin e projekteve dhe thithjeve të fondeve në kërkimin shkencor, ndërsa Programi i bursave do të mbështesë të rinjtë ekselehtë për të vijuar studimet e tyre brenda dhe jashtë vendit.



## Shpallja e kampioneve përmbylli edicionin III të Ekipëve Sportive në Shkollë

Finalet e voleybollit dhe basketbollit për shkollat e mesme përmbyllën edicionin III të Kampionatit të Ekipëve Sportive në Shkollë, ku përgjatë gjithë vitit angazhohen rreth 12 mijë nxënës. Me një atmosferë emocionuese, skuadra e vajzave të Vlorës dhe ajo e djemve të Elbasanit fituan ndaj Qarkut të Kukësit. Vajzat e Sarandës, pjesë e ekipit të Qarkut të Vlorës u shpallën kampione në basketboll përballë Tiranës. Për djem, triumfoi Qarku i Lezhës përballë Qarkut të Vlorës. Edhe ky edicion i tretë u përmbyll me sukses, duke dëshmuar rolin që sporti ka në promovimin e një jete të shëndetshme për të rinjtë.



## Rrjetet europiane të njohjes së kualifikimeve u mblodhën në Tiranë

Rreth 150 përfaqësues dhe ekspertë të arsimit të lartë u mblodhën në Tiranë, në kuadër të takimit të 32-të të rrjetit ENIC-NARIC (European Network of Information Centres dhe National Academic Recognition Information Centres in the European Union). Një tryezë ku u ndanë eksperiencat më të mira dhe u diskutua mbi sfidat e përbashkëta në fushën e njohjes së kualifikimeve akademike dhe profesionale. Shqipëria po punon për të kaluar nga një proces tradicional i njohjes, drejt njohjes automatike, përmes digitalizimit të procedurave, krijimit të bazave të të dhënave kombëtare dhe ndërkombëtare për verifikimin e institucioneve dhe programeve, përmes ngritjes së platformave të dedikuara dhe efikase (SMIAL).